



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 52, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, në Seancën plenare të mbajtur më 15 tetor dhe 7 nëntor 2018, me propozimin e deputetes Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, pas harmonizimit të tekstit edhe me grupet tjera parlamentare, miratoi këtë:

REZOLUTË

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës i kërkon Qeverisë së Republikës së Kosovës të hartojë dhe zbatojë sa më parë legjislacionin për ndarje të shtesave për fëmijë në Republikën e Kosovës.
2. Ndarja e shtesave për fëmijë të fillojë gjatë vitit 2019.
3. Shuma mujore e shtesave për fëmijë duhet të kategorizohet, duke marrë parasysh kriteret përkatëse, duke përfshirë të hyrat familjare, punësimin e prindërve dhe moshën e fëmijëve.

Nr. 06-R- 014

Prishtinë, 07.11.2018

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Rezoluta u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Grupeve parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit.